



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 18.07.2025  
Numër protokollit: 5062/2025

A.nr.1080/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.1080/2025 të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi F.M kundër organit të punësimit/Ministria e Mbrojtjes, në çështjen juridike “*transferim pas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.07.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1080/2025, të datës 04.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, F.M.

## A r s y e t i m

Ankuesi, F.M (*më tej referuar vetëm* Ankuesi), më datë 04.06.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3783/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.1080/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Ref.DBN-MM-5/362/2025 të datës 23.04.2025, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes, lidhur me ri sistemimin pas riorganizimit të TOP-it në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ndërsa, ankuesi më datë 23.06.2025, përmes shkresës me numër protokollit 4274/2025, ka tërhequr ankesën e datës 04.06.2025, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 23.06.2025, të ankuesit për tërheqje nga ankesa A.nr.1080/2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1080/2025 të datës 04.06.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.1080/2025**

**Atdhe GASHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit F.M;
- Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.